



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 11.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.09.2020 të parashtruar nga Operatorit Ekonomik "PE-VLA-KU" sh.p.k.- Dega në Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Rishpallje "Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri", me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "PE-VLA-KU" sh.p.k.- Dega në Kosovë, e dt. 09.09.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit Rishpallje "Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri", me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 07.09.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 07.09.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "PE-VLA-KU" sh.p.k.- Dega në Kosovë, me datë 09.09.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Rishpallje "Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri", me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 11.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Udhëheqësja e punishtes znj. Mimoza Mehmetaj ne dosjen e dorëzuar nga OE Pevlaku nuk është në listën zyrtare (ATK), por posedon një kontratë pune të dt: 01.02.2018, në paragrafin e katërt të kontratës shkruan: Afati i punësimit është për një periudhë të pacaktuar. Kontrata është e noterizuar nga NOTER Astrit S. Bibaj.
2. Ju keni prezantuar CV-in e znj. Mimoza Mehmetaj, nuk është e nënshkruar, por është e Noterizuar.

Ndërsa, pas kërkesës për sqarim (plotësim të dokumentave shtesë), nga ju na është prezantuar një kontratë e re mbi vepër e nënshkruar specifikisht për këtë projekt.

3. Te Lëshesa pllakore në stacionazhat 1+416 km dhe 2+922 km të Punët e Armimit, nuk është mbledhë pozicioni V.1. Furnizimi, punimi dhe vendosja e armaturës nga Φ 10mm deri në Φ 16 mm: $21368.90 \text{ kg} \times 1.00 = 21,368.90 \text{ €}$

Të Rekapitulimi i Lëshesës pllakore totali del gjithsej më TVSH 72,781.50 € e jo 51,412.60 € sikur në Ofertë

Në total kontrata nuk është 3,474,948.86 € por 3,496,317.76 €

Tek pika :Nje inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinierise mekanike – drejtimi komunikacion(transport) me minimum pesë vite përvojë pune pas diplomimit-OE ka sjellur inxhinierin me diplome te Ndermtarise-dega infrastrukture rrugore ,gje qe nuk e plotson kerkesen e parashtruar te Investitorit.

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik “Drini Company” sh.p.k, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kerkesat e Autoritetit Kontraktues

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës

Faton Gataj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

